

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Përdëllimi¹ / *el-Ishfaak* / الإشفاق

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Ata thonë: Vërtet ne edhe më parë frikësoheshim në mesin e familjeve tona.”
(et-Tûr, 26)

Përdëllimi është shqetësimi i kombinuar me dhembshuri. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë:

- Përdëllimi për shpirtin tënd se mos po refuzon²
- Përdëllimi për veprat e tua se mos po humbin³
- Përdëllimi për njerëzit nga dija që ke për justifikimet e tyre⁴

Niveli i dytë:

- Përdëllimi për kohën se mos po cenohet nga shpërhapja (në gjëra të gabuara)
- Përdëllimi për zemrën se mos po pengohet nga ndonjë barrikadë⁵
- Përdëllimi për sigurinë tënde se mos po priset nga (të parët e) ndonjë shkak⁶

¹ Të kesh frikë për veten tënde e për të tjerët dhe ta ndiesh vuajtjen tënde e të të tjerëve, gjë që të shtyn të veprosh apo të ofrosh ndihmë.

² Rebelim kundra ndonjë kërkesë të robërimit ndaj Zotit (*ubudijeh*).

³ Veprat, ndër të tjera arsye, mund të humbin edhe për arsye të qëllimeve të këqija dhe mburrësisë.

⁴ Pavarësisht justifikimit të tyre, që s'i mbron dot nga pasojat e punëve të këqija që i bëjnë, ti ende ndien keqardhje për ata që i dorëzohen shejtanit dhe padrejtësive të vetë atyre.

⁵ Plogështia shpirtërore, joshjet, keqkuptimet apo ndonjë barrikadë tjetër që do ta pengonte zemrën të vazhdojë rrugëtimin e saj.

Niveli i tretë:

- Përdëllimi që mbron punën tënde nga mburrësia⁷
- Përdëllimi që të mbron nga konflikti me njerëz⁸
- Përdëllimi që të mban të përkushtuar (në shtegun e pastrimit shpirtëror)

⁶ Kjo s'do të thotë që të mos besosh në shkaqe (*asbaab*), siç është të qenët e besimit një shkak për shpërblim dhe të qenët e mosbesimit një shkak për ndëshkim. Imam Ibn el-Kajjim paralajmëroi në komentimin e tij se theksimi i tepërt i shejhut (el-Harawit) të konceptit të *fanaa*-s (asgjësimit) dhe nënvlerësimi i shkaqeve mund të shkaktojë keqkuptim dhe konfuzion. Shpresohet se shejhu (el-Harawi) kishte për qëllim atë se të parët e shkaqeve s'duhet të të parandalojë nga besimi i plotë në shaktarin dhe nga të qenët i sigurt për kontrollin absolut të Tij.

⁷ Pretendimi shkatërron veprën para se ajo të ndodhë, ndërsa mburrësia e shkatërron veprën pasi ajo të ndodhë.

⁸ Sepse konflikti me njerëz prish sjelljen dhe dëmton mirëqenien e zemrës.